



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2889/Prot.

2

Tiranë më 01.11.2022

VENDIM

Nr. 27, datë 31.10.2022

“Mbi miratimin e kuotave shtesë të pranimit në programin e ciklit të tretë të studimeve Master Ekzekutiv në Kriminologji, në Fakultetin e Drejtësisë, për vitin akademik 2022-2023”

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3; neni 25, pika 7; neni 37, pikat 1 e 2; neni 38, pika 1 dhe pika 3; Vendimin e Senatit Akademik nr. 06, datë 15.03.2022 “Mbi miratimin e kuotave të pranimit në programet e studimeve të ciklit të dytë, si dhe në ciklin e tretë të studimeve, Master Ekzekutiv në Kriminologji, për vitin akademik 2022-2023”, në Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 14, pika 5, gërma “d”, dhe neni 31, gërma “q”; si dhe në propozimin e Fakultetit të Drejtësisë me shkresën nr. 737/2 prot., datë 28.10.2022, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës;

VENDOSI:

1. Të miratojë kuotat shtesë të pranimit në Fakultetin e Drejtësisë, për vitin akademik 2022-2023, në programin e ciklit të tretë të studimeve Master Ekzekutiv në Kriminologji.
2. Numri i kuotave shtesë të pranimit për programin e studimit Master Ekzekutiv në Kriminologji është 15.
3. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Prof. Dr. Artan Hoxha

